



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

I nderuar Z. Kryetar i Komisionit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Fillimisht, më lejoni t'ju falenderoj për mundësinë për të prezantuar përpara jush Raportin Vjetor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2021.

Edhe pse 2021 vazhdoi të ishte një vit sfidues për ekonominë dhe tregjet financiare, kjo si pasojë e presionit të ushtruar nga rikthimi i valës së pandemisë, përsëri ekonomia u rrit ndjeshëm dhe tregjet financiare u rimëkëmbën në mënyrë të shpejtë duke treguar qëndrueshmëri përballë luhatjeve të mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm. Rimëkëmbja u konstatua si në nivel të ardhurash në primet e sigurimeve, ashtu dhe në aktivet e fondeve të investimeve dhe të pensioneve private. Kjo qëndrueshmëri e tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, përfshi këtu edhe trajtimin e pagesave të tërmeteve, sugjeron se sektori ka kapacitetin të përballojë presionet e mundshme nga rreziqet e shtuara që paraqet situata aktuale.

Në fund të vitit 2021, totali i aseteve në tregjet nën mbikëqyrjen e AMF arriti në rreth 128 miliardë lekë, me një rritje prej 15.9% krahasuar me vitin 2020. Pesha e aseteve ka arritur në 7.3% të PBB.

Tregu i sigurimeve dhe ai i pensioneve private kanë vijuar rritjen edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2022, ndërsa konstatohet një rënie e lehtë në nivelin – 1% në asetet e fondeve të investimit, kryesisht si pasojë e luhatshmërisë në tregjet ndërkombëtare për shkak të konfliktit Rusi-Ukrainë. Megjithatë, ekspozimi i fondeve tona të investimit ndaj këtyre tregjeve mbetet i kufizuar dhe po monitorohet në mënyrë të kujdesshme nga Autoriteti.

Në një vlerësim të përgjithshëm tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit mbeten të qëndrueshme, me tregues të mirë të likuiditetit, të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të mbulimit me provigjone.

2021 ka qenë një tjetër vit intensiv në terma të riformatimit të bazës ligjore dhe rregullatore të tregjeve nën mbikëqyrje. Avancimet ligjore janë vlerësuar edhe në Raportin e fundit të Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, ku në veçanti është përmendur miratimi i Ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili vlerësohet se është në përputhje me direktivat e BE-së. Gjithashtu, raporti evidenton ligjet e reja për tregjet e kapitalit, sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe tregjet financiare të bazuara në regjistrat e shpërndarë, si edhe

rregulloret e hartuara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në këtë drejtim. Raporti thekson se këto akte përafrojnë më tej kuadrin ligjor të Shqipërisë me Direktivat Evropiane dhe në këtë kontekst gjej rastin të falenderoj edhe njëherë Komisionin e Ekonomisë, për mbështetjen në miratimin e këtyre akteve të rëndësishme ligjore.

Gjithashtu Autoriteti ka hartuar projektligjin e ri “Për fondet e pensionit privat”, në përputhje me direktivën e re të BE-së, projektligji i cili është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe është në fazën e konsultimit.

Në zbatim të kërkesave të Ligjit “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe të ligjit “Për tregjet e kapitalit”, shoqëritë që operojnë në këto tregje i janë nënshtruar një procesi të imtësishëm përshtatshmërie, ku u morën në shqyrtim në mënyrë të detajuar një sërë elementësh, përfshirë standardet e qeverisjes, procedurat administrative dhe kontabël për vlerësimin e riskut, certifikimin e personave dhe personelit kyç, etj.

Për t’u veçuar është aderimi së fundmi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), në funksion të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mbikëqyrësve në tregun e sigurimeve. Kjo është realizuar pas një procesi rigoroz të verifikimit të përputhshmërisë së bazës ligjore dhe rregullatore me standardet ndërkombëtare të IAIS.

Gjithashtu, Autoriteti në cilësinë e kryesuesit të Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”, në bashkëpunim me institucionet kontribuese në këtë kapitull, ka realizuar koordinimin, raportimet dhe takimet e posaçme në nënkomitete si dhe ndjekjen e realizimit të planit kombëtar të integritetit për këtë kapitull.

Zonja dhe zotërinj deputetë, në vijim po ndalem me detaje në ecurinë e tregjeve nën mbikëqyrje, impaktin që kanë sjellë ligjet e reja të miratuara, si edhe zhvillime të tjera të rëndësishme.

Tregu i sigurimeve, në nivel primesh, në vitin 2021, shënoi një rritje me 16%, krahasuar me vitin 2020, duke arritur në rreth 19.3 miliardë lekë. Rritje ka patur edhe krahasuar me periudhën e parapandemisë, vitin 2019, me 9.4%. Në sigurimin Jo-Jetë, i cili vijoi të dominojë tregun e sigurimeve, rritja e të ardhurave konstatohet në të gjithë linjat kryesore të biznesit. Tregu i sigurimeve vijoi të jetë i dominuar nga sigurimet e detyrueshme, që zënë 61.6% të totalit, përkundrajt 38.4% që janë sigurimet vullnetare. Rritje primesh u shënuar edhe sa i përket aktivitetit të Jetës, me 22.7% krahasuar me vitin 2020.

Konstatohet një rritje e ndjeshme e vlerës së paguar të dëmeve në sigurimin motorik, me rreth 20% krahasuar me një vit më parë. Ndërsa në nivel tregu, totali i dëmeve të paguara për vitin 2021 arriti në 6.7 miliardë lekë, me një rënie prej 11%, kryesisht për shkak të pagesës së pjesës më të madhe

të dëmeve të tërmetit përgjatë vitit 2020. Sa i përket Fondit të Kompensimit, u paguan 269 milionë lekë dëme, për një realizim pagesash prej rreth 104% të fondit.

Në fund të vitit 2021, totali i aktiveve të tregut të sigurimeve vlerësohet në rreth 41 miliardë lekë. Tregu i sigurimeve ka një rritje me 11% të nivelit të aktiveve likuide, krahasuar me fundin e vitit 2020, ndërsa sa i përket provigjoneve teknike, në total tregu, ka një rritje me rreth 900 milionë lekë, ose 5%, duke arritur në rreth 22 miliardë lekë.

Ligji për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, i cili hyri në fuqi në korrik të vitit të kaluar, ka sjellë ndryshime të rëndësishme në segmentin kryesor të tregut të sigurimeve, atë të sigurimeve motorike.

Ligji ka rritur masën e dëmshpërblimit për disa kategori dëmsh dhe ka parashikuar rregulla e procedura më të qarta në përcaktimin e dëmshpërblimit në rastin e aksidenteve. Është saktësuar afati i trajtimit të dëmeve, rritja e masës së dëmshpërblimit për dëmin pasuror në përgjithësi dhe në veçanti për të miturit. Ligji ka adresuar problematikat lidhur me Fondin e Kompensimit, duke parashikuar ndër të tjera dëmshpërblimin e drejtpërdrejtë nga kompanitë e sigurimit, si dhe një fond garancie, në vlerën prej 150 milionë lekë, për t'u përdorur për rastet që shkojnë për Fond Kompensimi. Ligji parashikon për herë të parë mbajtjen e provigjoneve nga shoqëritë e sigurimit lidhur me dëmet objekt Fond Kompensimi dhe Autoriteti gjatë këtij viti ka miratuar shumën prej 765 milionë lekë, si provigjone, për pagesën e dëmeve për Fondin e Kompensimit.

Një tjetër parashikim i ligjit të ri ka të bëjë me kufizimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim nga ana e shoqërive të sigurimit. Në janar të këtij viti, hyri në fuqi rregullorja e miratuar nga Autoriteti ku parashikohet se shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës nuk mund të aplikojnë në total komisione ndërmjetësimi për policat e sigurimit të detyrueshëm më të lartë se 20% e primeve të shkuara bruto. Kjo vlerë do të zbresë në 18%, duke nisur nga janari i vitit të ardhshëm. Nga raportimet e shoqërive për tremujorin e parë 2022 rezulton se komisionet e ndërmjetësimi për policat e sigurimit të detyrueshëm kanë zbritur aktualisht në një mesatare prej 18.5% nga afro 27.5% që ishin përpara kufizimit nga Autoriteti.

Sa i përket tregut të **fondeve të investimeve**, gjatë vitit të kaluar, ushtruan aktivitetin e tyre 11 fonde investime me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike.

Totali i aseteve neto të tregut të Sipërmarrjeve të investimeve kolektive në fund të vitit 2021 arriti në 81.9 miliardë lekë, me një rritje prej 21.5% krahasuar me vitin 2020. Numri i anëtarëve në tregun e fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike arriti në mbi 40 mijë, duke shënuar një rritje me rreth 22.7%.

Tregu i fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike dominohet kryesisht nga investimet në obligacione dhe bono thesari të Republikës së Shqipërisë, të cilat përbëjnë rreth 81.5% të asetëve të këtij tregu. Në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e rregullator, Shoqëritë Administruese kanë mbajtur likuiditete të nevojshme për fondet e investimit. Nga mbikëqyrja e këtij tregu, gjatë vitit 2021, mbështetur në raportimin financiar të shoqërive administruese, rezultoi se treguesit e likuiditetit për të gjitha fondet e investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike kanë qenë në përputhje me kërkesat e bazës rregullatore për likuiditetin.

Nisur nga rreziqet e mundshme që paraqet situata aktuale, Bordi i Autoritetit miratoi një udhëzim të posaçëm mbi pritshmëritë rregullatore lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive, ku kërkoi vëmendje të shtuar nga shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive lidhur me treguesit e likuiditetit, treguesit sintetik të përfitimit dhe rrezikut si dhe kryerjen e stres-testeve me një qasje edhe më konservative ndaj flukseve dalëse.

Për shkak të kërkesave të ligjit të ri, **shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive** me ofertë publike, fondet e investimeve dhe depozitarët e tyre iu nënshtuan procesit të përshtatjes së veprimtarisë me kërkesat e kuadrit rregullator të përcaktuar nga Ligji nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe rregulloreve në zbatim të tij. Autoriteti mori në shqyrtim standardet e qeverisjes së brendshme, procedurat administrative dhe kontabël për vlerësimin e riskut, sistemet që mbulojnë aktivitetin e shoqërisë administruese dhe masat mbrojtëse për sistemet e përpunimit të informacionit, mekanizmat e kontrollit të brendshëm, si edhe përmbushjen e të gjitha kërkesave për përshtatshmërinë dhe aftësinë e personave dhe personelit kyç.

Ligji i ri ka rritur më tej mbrojtjen e investitorit, përmes rritjes së kërkesave në dhënien e informacioneve shpjeguese në dokumentacionin që i vihet në dispozicion investitorëve. Gjithashtu, ligji ka shtuar kërkesat për transparencën dhe menaxhimin e rrezikut nga ana e shoqërive administruese të investimeve kolektive.

Tregu i **fondeve të pensioneve private**, edhe pse me peshë modeste ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto, gjatë vitit 2021 shënoi një rritje prej 27.2% krahasuar me vitin 2020 duke arritur një total asetesh neto prej 4.58 miliardë lekë. Asetet e këtij tregu janë investuar kryesisht në obligacione të Qeverisë shqiptare, të cilat përbëjnë rreth 91.5% të totalit të asetëve të fondeve të pensioneve private.

Me qëllim përafrimin me Direktivën Evropiane IORP II, standardet më të mira ndërkombëtare, si dhe përmirësimin e bazës ligjore që rregullon tregun e fondeve të pensionit privat, Autoriteti ka hartuar projektligjin “Për fondet e pensionit privat”. Dokumenti i është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe aktualisht është në fazën e konsultimit ndërinstitucional. Projektligji sjell disa risi, ku veçohen format e reja të fondeve të pensionit, duke parashikuar fonde

pensioni me pjesëmarrje të hapur dhe të mbyllur, rritjen e transparencës dhe informimit për anëtarët, zhvillimin e tregut përmes rishikimit të politikës së investimit të asetëve, nxitjen e pjesëmarrjes përmes rishikimit të regjimit fiskal, si dhe përmirësimin e mirëqeverisjes së shoqërive administruese të fondeve.

Sa i përket **tregut të kapitaleve**, tashmë baza ligjore dhe infrastruktura e tregtimit dhe pastregtimit është e kompletuar. Aktualisht tregu i kapitaleve përbëhet nga tregu i titujve të Qeverisë Shqiptare, që është edhe segmenti më i madh dhe aktiv, si edhe tregu i obligacioneve me ofertë private. Në tregun e kapitaleve gjatë vitit 2021 vepruan 13 subjekte për ofrimin e shërbimit të investimeve, nga të cilat 10 banka, që janë operatorët më aktivë në tregtimin e titujve të Qeverisë. Tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private ka përjetuar një dinamikë rritëse, ku shuma e pashlyer e këtyre obligacioneve arriti në 10 miliardë lekë në fund të vitit 2021, duke u rritur me 25% krahasuar me vitin 2020.

Ligji i ri për tregjet e kapitalit, i cili është në përputhje me Direktivën MIFID II ka rritur kërkesat për subjektet, si edhe ka krijuar mundësi të reja për zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu. Kështu, krahas ofrimit të shërbimeve bazë të investimit, disa nga bankat kanë zgjeruar tashmë licencën për ofrimin e shërbimit të këshillimit të investimeve, administrimit të portofoleve individuale apo nënshkrimit të titujve me apo pa angazhim shitjeje, si edhe ofrimin e shërbimeve ndihmëse.

Krijimi i mundësive të ndërlidhjes me tregjet globale ka sjellë dimensione të reja, favorizuar edhe nga zhvillimet teknologjike në industrinë e shërbimeve financiare. Kështu bankat mund t'iu ofrojnë klientëve të tyre instrumente financiare që tregtohen në tregjet ndërkombëtare, të ndërveprojnë me banka të huaja që ofrojnë shërbime investimi, apo edhe të ofrojnë akses të drejtpërdrejtë në platformat online të tregtimit. Ligji i ri parashikon mundësinë e ofrimit të një game të gjerë të instrumenteve financiare, duke dhënë më tepër mundësi për alternativa të diversifikuara investimi.

Gjithashtu, ligji ka vendosur standarde më të larta në kuadrin licencues dhe mbikëqyres të subjekteve që operojnë në tregjet e kapitalit. Subjektet aktuale i janë nënshtruar një procesi të plotë përshtatshmërie, që ka përfshirë rishikimin dhe përditësimin e rregullave dhe procedurave të tyre operacionale, rishikimin e kontratave me klientin, si dhe hartimin e rregullave dhe procedurave të reja në zbatim të kërkesave ligjore.

Për herë të parë shoqërive komisionere dhe bankave ju është kërkuar dhe kanë hartuar dokumentin e politikave të ekzekutimit më të mirë të urdhërit të klientit, ku përcaktohet mënyra se si këto subjekte do arrijnë rezultatin më të mirë të mundshëm gjatë kryerjes dhe ekzekutimit të një transaksioni me tituj për klientët. Gjithashtu, për herë të parë, janë hartuar metodologjitë për mënyrën e testimit dhe vlerësimit të klientit në lidhje me përshtatshmërinë e tij ndaj llojit të investimit dhe përcaktimit të rrezikut të mundshëm që merret përsipër nga klienti.

Sa i përket ligjit të ri për shërbimet financiare bazuar në regjistrat e shpërndarë, ku Autoriteti është institucion rregullator bashkarisht me AKSHI-n, janë miratuar një pjesë e rregulloreve dhe po vijohet me kompletimin e të gjithë akteve nënligjore në zbatim të ligjit. Aktualisht, pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nuk ka mbërritur asnjë kërkesë për licencim bazuar në këtë ligj.

Autoriteti i ka kushtuar vëmendje të posaçme proceseve të digjitalizimit, si dhe përmirësimit në vazhdimësi të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe atyre të raportimit. Një nga zhvillimet për t'u evidentuar është integrimi i plotë i shërbimeve që lidhen me sigurimin e detyrueshëm në portalin e-Albania. Në këtë mënyrë, rreth 680 mijë qytetarë të cilët pajisen çdo vit me një policë të sigurimit të detyrueshëm motorik, (tpl apo karton jeshil) mund të aksesojnë informacionet apo vërtetimet e nevojshme në lidhje me vlefshmërinë e policës së tyre aktuale të sigurimit, historikun e sigurimit të mjeteve, historikun e dëmeve, si dhe të njoftohen në kohë përpara afatit të skadimit të siguracionit të tyre, në mënyrë që ta rinovojnë atë. Policat e sigurimit të detyrueshëm motorik, të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit, raportohen në kohë reale në Regjistrin Online të AMF-së, i cili në ndërveprim me e-Albania u mundëson qytetarëve që të verifikojnë po në kohë reale policën e tyre të sigurimit të detyrueshëm. Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve, Autoriteti realizoi gjatë vitit 2021, një përditësim të AMF In-Reg, që është sistemi i raportimit në tregun e sigurimeve. Përditësimi ka sjellë rritje të shkallës së sigurisë, si edhe ofrimin e disa funksioneve të reja, që kanë të bëjnë me gjenerimin e raporteve analitike, në funksion të mbikëqyrjes së tregut.

Autoriteti i ka kushtuar vëmendje forcimit të kapaciteteve dhe zhvillimit profesional të punonjësve, duke mundësuar trajnime të ndryshme, edhe në kuadër të projekteve të asistencës, si edhe përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira profesionale me autoritetet homologe, si dhe me shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve. Gjithashtu, Autoriteti ka vijuar me trajnimet për aftësimin profesional dhe edukimin në vazhdim të profesionistëve që operojnë në tregjet nën mbikëqyrje. Në fokus kanë qenë nismat për rritjen e edukimit financiar dhe mbrojtjen e konsumatorit. Në këtë drejtim, Autoriteti ka ulur afatet e trajtimit të ankesave, ndërkohë që për vitin 2021, pas ndërhyrjes së AMF janë zgjidhur rreth 58% e ankesave të qytetarëve.

Të nderuar deputetë, në fund të fjalës time, më lejoni të ndaj me ju disa nga drejtimet kryesore ku do të përqendrohet veprimtaria e Autoritetit gjatë vitit në vazhdim:

Autoriteti do të përfundojë miratimin e pjesës së mbetur të rregulloreve në zbatim të tregjeve të kapitalit, me asistencën e ekspertëve të Bankës Botërore, pjesë e projektit “Forcimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të AMF: Fokusi tek Zhvillimi i Tregut të Kapitaleve” (SECO II).

Gjithashtu synohet që në një kohë të afërt projektligji “Për fondet private të pensionit”, të kalojë fazat e nevojshme të miratimit në Qeveri dhe t’i paraqitet Kuvendit për shqyrtim.

Gjatë këtij viti dhe në vijim, prioritet i Autoritetit do të jetë forcimi i mëtijshëm i funksionit mbikëqyrës dhe përafrimi me standardet ndërkombëtare. Autoriteti, në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore, do të finalizojë një vlerësim të plotë të përputhshmërisë me Parimet Themelore Ndërkombëtare në Sigurime, ICP-të, me qëllim avancimin drejt standardeve më të mira.

Gjatë vitit 2022 Autoriteti do të vijojë rolin e tij proaktiv në funksion të mirërregullimit dhe zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Do të synohet finalizimi dhe implementimi i strategjisë për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së emetuesve, zgjerimit të gamës së instrumenteve financiare, përmirësimit të eficiencës së tregut dhe zgjerimit të bazës së investitorit. Për të arritur këtë, Autoriteti do të vijojë bashkëpunimin me institucionet me rol kyç për zhvillimin e tregut (si Ministria e Financave apo Banka e Shqipërisë) si dhe me aktorët e tregut apo institucione ndërkombëtare.

Synim kryesor mbetet mbikëqyrja e kujdesshme e tregjeve dhe treguesve kryesorë financiarë me qëllim ruajtjen e stabilitetit dhe shëndetshmërisë së subjekteve në mbikëqyrje.

Faleminderit!